

Korrupsioni si një problem shoqëror

1. **Korrupsioni nuk është problem kyç i qytetarëve.** Si edhe nga hulumtimi i vitit 2016 dhe 2014, korrupsioni vazhdon të gjendet në vendin e pestë sipas qytetarëve si problem shoqëror. Për qytetarët më të rëndësishme janë çështjet e natyrës ekzistenciale, si papunësia, varfëria dhe të ardhurat e ulëta, por edhe jostabiliteti politik. Menjëherë pas tyre pason korrupsioni, ndërsa me rritjen e evidentuar të krimit si problem i qytetarëve, mund të llogaritet se korrupsioni dhe krimi krijojnë një ndjenjë të brengës së lartë te qytetarët.

Përvojat me korrupsionin

2. **Trendi i rritjes së presionit korruptiv dhe përfshirjes në korrupsion vazhdon.** Presioni korruptiv nga ana e personave zyrtar dhe përfshirja nga ana e qytetarëve shënojnë një rritje në krahasim me hulumtimet e vitit 2014 dhe 2016. Në vitin 2018, 36,3% të qytetarëve kanë përjetuar një presion korruptiv, që do të thotë rritje për 5,8 për qind në krahasim me vitin 2016 dhe 10 për qind në krahasim me vitin 2014. Nga ana tjetër, në vitin 2018 është vërejtur një rritje e rezistencës ndaj korrupsionit, gjegjësisht presion është bërë mbi 36,3% të popullatës, ndërsa përfshirja është 31,4%. Në vitin 2016, dallimi mes presionit dhe përfshirjes ka qenë vetëm një për qind.
3. **Korrupsioni mbetet i padënueshëm në Maqedoni.** Nëse kemi parasysh se 31,4% të të anketuarve kanë pohuar se kanë qenë të përfshirë në korrupsion, ndërsa kjo e projektuar në popullatë është 519.727, arrihet në përfundim se janë kryer së paku gjysmë milioni vepra penale nga fusha e korrupsionit. Nga ana tjetër, në vitin 2016, vetëm 154 persona janë dënuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare apo për ryshfet, që do të thotë se shkalla e efikasitetit të institucioneve është 0,33% të rasteve të zbuluara dhe të mbyllura me dënim.
4. **Ekzistojnë dallime të konsiderueshme demografike në raport me presionin dhe përfshirjen në korrupsion.** Shqiptarët në Maqedoni ballafaqohen me një presion mjaft më të madh për korrupsion në krahasim me maqedonasit. Nga qytetarët të cilët kanë pasur kontakt me administratën, 81% të shqiptarëve kanë përjetuar presion për korrupsion, përballë 53% të maqedonaseve. Si rezultat i kësaj, shqiptarët në një sasi më të madhe, apo 74% kanë qenë të përfshirë në korrupsion, për dallim nga 47% maqedonas.
5. **Qytetarët nuk denoncojnë korrupsion.** Qytetarë e Maqedonisë shumë rrallë i denoncojnë rastet kur nga ta kërkohet diçka me qëllim që ta zgjidhin ndonjë problem të vetin. Numri i lartë prej 90,6% të qytetarëve nuk kanë denoncuar rast korrupsioni të ndonjë institucioni të ngarkuar për ankesa, përballë vetëm 4,7% të cilët e kanë denoncuar rastin në ndonjë institucion. Krahasuar me vitin 2016, kjo përqindje është rritur, që paraqet ulje të besimit të qytetarëve në institucionet te të cilat është denoncuar korrupsioni.

Qëndrime për korrupsionin

6. **Qytetarët kanë një nivel të lartë të vetëdijes për korrupsionin.** Si edhe gjatë viteve të kaluara, një përqindje e lartë prej 69% të qytetarëve janë të vetëdijshëm për sjelljen korruptive, dhe jo vetëm për dhënie ryshfet, por edhe për forma më të ndërlikuara të korrupsionit, siç është nepotizmi, klientalizmi etj. Megjithatë, qytetarët më lehtë njohin korrupsion kur ka këmbim parash sesa ndonjë tjetër lloj korrupsioni, kështu që forma më e dallueshme është dhënia para një zyrtari policie, për të mos mbetur pa patentë shoferi.
7. **Rritja e pranisë së korrupsionit.** Trendi i pranisë së korrupsionit është në rritje e sipër në krahasim me vitet e kaluara. Në vitin 2018 popullata është e ndarë në raport me pranimin e

praktikave korruptive dhe është për tre për qind më shumë sesa në vitin 2016, gjegjësisht për pesë për qind më shumë në krahasim me vitin 2014. E projektuar me numrin e popullatës, kjo do të thotë se për 827.590 qytetarë korrupsioni është mënyrë e pranueshme e sjelljes. Lartësia e këtij numri paraqet një problem të rëndësishëm dhe një mospajtim të madh në ballafaqimin me korrupsionin, si dhe zhvillimin e politikës kundër korrupsionit.

8. **Të rinjtë më tolerant ndaj korrupsionit.** Ajo që brengos dhe të cilës duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje në të ardhmen është toleranca më e madhe, gjegjësisht pranimi i korrupsionit nga ana e të rinjve në moshë prej 18 deri 29 vjet, në krahasim me moshat e tjera. Kështu, për 64,2% të të rinjve në këtë moshë është e papranueshme të japin para për të zgjidhur ndonjë problem, që është një përqindje e lartë prej 9,6% më pak nga papranueshmëria mesatare (73,8%).
9. **Sjellja e supozuar për nënshtrim nga korrupsioni mbetet e pandryshuar.** Niveli i nënshtrimit nga korrupsioni në krahasim me vitin 2016 mbetet në të njëjtin nivel. Kështu, 45% të qytetarëve janë të nënshtrueshëm nga korrupsioni, 25% të tjerë kanë një sjellje të përzier. Sikur qytetarët të jenë në pozitë të korruptohen, gjegjësisht të marrin ndonjë kompensim në para, dhuratë apo shërbim, pothuajse gjysma e tyre (45,8%) thonë se këtë kurrë nuk do ta bënin, sepse nuk arsyetojnë punë të tilla.

Perceptimi për korrupsionin: potencial për preventivë nga korrupsioni

10. **Qytetarët me pritshmëri të larta për presionin korruptiv edhe në të ardhmen.** Një shumicë e madhe e qytetarëve (87%) konsideron se edhe në të ardhmen do të ekzistojë mundësia apo mundësia e madhe për presion korruptiv. Në krahasim me vitin 2016 ekziston përqendrim, gjegjësisht për 12 për qind është rritja e pritshmërisë nga presioni korruptiv. Nga kjo del rritja e pesimizmit dhe ulja e shpresës të qytetarët se do të ketë mundësi për ta luftuar korrupsionin. Qëndrimi i tillë i qytetarëve duhet të merret shumë seriozisht nga ana e Qeverisë dhe institucioneve përgjegjëse, me qëllim që të ndërmerren masa për t'u bindur qytetarët në vendosmërinë e paralajmëruar për luftë ndaj korrupsionit.
11. **Ekziston një përhapje e madhe e korrupsionit.** Më shumë se gjysma e qytetarëve (61,9%) konsideron se korrupsioni është i përhapur mes personave zyrtar. Dallime në perceptimet ekzistojnë në bazë etnike, gjegjësisht 70% të popullatës shqiptare konsideron se korrupsioni është shumë i përhapur mes personave zyrtar, ndërsa 58,4% të maqedonasve janë me këtë mendim. Dallime të konsiderueshme ka mes simpatizantëve të partive politike, gjegjësisht simpatizantët e LSDM në numër më të vogël (55,3%), në krahasim me partitë e tjera, kanë perceptimin për përhapjen e korrupsionit mes personave zyrtarë. Për dallim nga ta, 64,6% të VMRO-DPMNE dhe 60% të Besës kanë një perceptim të tillë.
12. **Gjykatësit dhe prokurorët publik të perceptuar si më të korruptuarit.** Korrupsioni ka hyrë në të gjitha profesionet të të gjitha segmenteve të pushtetit: gjyqësorit, ekzekutivit dhe ligjvënësit. Tre nga katër qytetarë konsiderojnë se gjykatësit dhe prokurorët publik janë më të korruptuarit. Krahas tyre, mbi 65% të qytetarëve konsiderojnë se deputetët, ministrat, liderët e partive politike dhe liderët lokal janë profesionet më të korruptuara. Për më pak se 40% të qytetarëve, përfaqësuesit e shoqatave qytetare, bankarët dhe arsimtarët janë më të korruptuarit. Më së paku qytetarë (20,7%) konsiderojnë se korrupsioni ka hyrë mes arsimtarëve.
13. **Përhapja e korrupsionit në sistemin gjyqësor vazhdon të jetë më e perceptuara nga ana e qytetarëve.** Si për nga profesioni, ashtu edhe për nga sektori, gjyqet dhe prokuroria janë dy nga tre sektorët udhëheqës të cilët perceptohen me korrupsion më të përhapur. Për

dallim nga vitet e kaluara, Ministria e Shëndetësisë dhe sipas të gjitha gjasave edhe sektori i përgjithshëm shëndetësor është parë si i dyti si fushë në të cilën korrupsioni është shumë i përhapur.

- 14. Qytetarët nuk janë optimistë për çrrënjosjen e korrupsionit.** Sa u përket perspektivave për luftë ndaj korrupsionit, 20,7% të qytetarëve konsideron se korrupsioni i lartë nuk mund të ulet, ndërsa pothuajse gjysma (46,9%) e qytetarëve konsideron se korrupsioni gjithmonë do të ekzistojë, por mund të ulet.

Besueshmëria e institucioneve

- 15. Ministria e Punëve të Brendshme, Qeveria dhe Prokuroria Speciale Publike kanë besueshmërinë më të madhe si institucione për luftë ndaj korrupsionit.** Qytetarët janë prononcuar se për luftë ndaj korrupsionit besim më të madh kanë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pastaj në Qeverinë dhe në Prokurorinë Speciale Publike. Gjyqet dhe Prokuroria Publike janë me besueshmëri më të ulët mes institucioneve. Simpatizantët e LSDM në pushtet kanë në masë të konsiderueshme besim më të madh në pothuajse të gjitha institucionet kundër korrupsionit në krahasim me simpatizantët e VMRO-DPMNE opozitare, të cilët kanë një besueshmëri më të ulët.